



Faik Deda

Isoja  
ekësaj  
toke  
POEZI

844-1  
032

Faik Deda

MOULADA

ALBANIA ALBIA

Isoja  
e kësaj  
toke



33288

POEZI

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

# MOTIVE NGA VENDLINDJA

## ΔΙΝΙÇAST MËNGJESI NË NIVICËT

Flakëritje ngjyrë gjaku përmbi kreshta,  
nis zhuzhima e bletëve nëpër hoje;  
pikon dritë dita ndër lugje e vreshta,  
koha rrjedh këngë në gurgullimë krojesh.

Tek ai plepi i bardhë i fëmijnisë sime,  
dy sorkadhe qetuan hapat ndanë ledhit;  
buzët e mallit  
nga bregu i kujtimeve,  
çlodhen mbi degëzat e brirëve të një dreri...

## TE PRAGU I SHTËPISË KU LINDA

Pikon e malluar  
një heshtje malli.

Prag' i shtëpisë,  
kryegëzimi im,  
ti që lind pranverën,

o i rrahuri suferina!...

Nga udh' e ngazëllimit  
gjer tek psherëtima,  
ndiej gjuhën e gurtë  
të gurëve të murmë.

Bari i avllisë qeton vallen,  
nën pikat e para të një shiu të qetë,  
dashuri e shpirtit  
pikon mbi gurët me heshtje të blertë.

Prag, o pragu i shtëpisë,  
ti, derti  
o malli im!...  
Bëj të thërras  
e, prap' e prap' bie në mendime...

Te shteg' i avllisë ПЕРИЦА  
blegërin e blegërin  
ai qengji i bukur i fëmijnisë sime...

libet që nuk jep me vërtetësitë  
mësimet foli gjithë del i mëp  
atjet em qëndroj se është çdo lloj  
vajzë që përdorit qëndrueshme

qëll en rreth që ishte që mëndo  
të vijë kurrë jo zotën e përfshin  
Hox en kërcem i taret jehon  
ëdhë që jet e alqet e foshë e është

## PEIZĀZH

Nata hapi krahët pa kuptuar,  
shtigjesh shtyhen lesat qetë-qetë;  
hën' e lədhur se ç'po rri menduar,  
një kanat të mbyllët dikë pret...

Nis përkunden panjat n'ato ledhe,  
qeni i leh hënës plot zemërim;  
larg, një culë seç ligjëron me derte,  
nga kopeja vjen një blegërim...

Clodhen pllajat ngyer në flori,  
gérhet një traktor tej përmbi grykë;  
tundet mani i moçmë në avlli,  
një kanat u mbyll, u çel një dritë...

desqda pañ  
dua ola  
gusl moj et obes

## U R A

Mbi pérroin e thellë  
e tē lashtë sa gurgullima,  
duke tokur prerazi dy brigje,  
një urë në vendlindje...

Gurët krejt skalitur  
me daltë dhembshkure.

Një nga një tē lidhur  
gurët në gjerdan —  
me gjilpërë pandryshkur  
derti pér vatan.

Sa herë që marr udhë  
se ç'më shfaqet ura.

Kaq shpesh  
ajo urë  
sado të jem larg.

Ja, ashtu... nga kömbët  
fare pak e ngrënë,

E pashlyer në kujtesë,  
nga malli — e rëndë.

Një urë në vendlindje.

## ETYD MËNGJESI

Tringëllin ndër tinguj,  
derdh drítë hap më hap,  
çdo jehonë honesh  
e tret pa kuptuar.

Tej nga shtegu  
fyelli  
çeli një kanat,  
për atje  
dy çape  
ç'u nisën nxituar...

## F'SHATI IM

Çati tē bardha,  
nga dielli pragjet,  
strehët buz' qershive.

Malet  
zbardhur bore,  
thinjur lashtësive;  
nga përrenj pa numër  
pak nga pak tē ngrënë.

Një lijen gëzimi supesh,  
ndër gjunjë  
lum' i vogël i argjendtë.

Ai lumë i fëmijërisë...

Rrallë rrjedh i heshtur,  
po gjithnjë më nge...

Çdo gjë krejt e re.  
I vjetër veç mulliri  
aty te pérroi  
nën një lug ujëshumë.

Ca rrënë ftonj,  
pakëz zhurmë,  
plepa  
dhe pareshtur shkumë...

Tej nga lugjet  
isoja vjen tretet  
mes jehonash mali.

Vija e mullirit —  
mërmërimë e pérjetshme.  
si koha,  
si malli.

Nëpër shushurimë bliresh  
zëra gazmorë  
që zbresin nga zalli.

## A K U A R E L

Emböl-emböl bie dyjarja nä pyll,  
herë-herë që larg dëgjohen blegërima.  
...Pa shih, shih:

buz' ledhit del një yll  
ku manushaqja deh

e trëndelina...

## D È S H I R È

Kérkoj mos yllin tim syri ma zë,  
pranë shtrungës e vështroja që fëmi;  
sa herë marr udhë, pas e ndjell atë  
po nuk e di, vallë ësht' a s'ësht' ai...

Të shihja yje më ndodhte gjer mesnatës,  
me ta hyja bisedë gjith' dhembshuri;  
lakmova shpesh ndër duar yjt' e largët,  
po vetëm një e mbajta fortanë gji...

Dhe ngjitesha ndër male për çdo verë,  
majëmalet un'i pata aq zili;  
jo mendje për të shitur te të tjerë  
po yllin tim ta kapja,

poezi!

## TRIMAVE U QESHTE YLLI

### NË VATRAT SHQIPTARE

*Xhorxh Gordon Bajronit*

Ç'mi deshi shpirti dallgët dhe kushtrimin  
po, n'ato brigje, pashë vetë krenarinë;  
ky gjoksi im nuk reshtte nga gufimi  
për besën tuaj, nderin, burrërinë...

...Tek ecja buzë mbrëmjes shihja malet,  
prej maleve te balli ç'u pikon lavdia;  
po ç'qe tërë ai gaz që fshinte hallet,  
kur në trapez me ju ngrihej dollia?!

Nuk keni, mbase, shumë e shumë stolira  
përtej kalave, maleve, Aliut,  
veç n'ato brigje s'shterej bukuria,  
tek frynte me aq mall pérreth veriu...

I veshur në një dhomë me oxhak,  
me rrobat më të bukura të botës,  
tek dal të shoh bedenash rrëth e qark —  
armët llamburisnin në pasqyrë të Vjosës...

S'u stepet syri shqotave pa fund,  
ndonëse për një lule u drithërohet qerpiku;  
ç'ish gjith' ai prush që dritë derdhë gjithkund,  
kur buzë vatrës ulej edhe miku!...

Përmbi fytyrë ju hiqej shpejt çdo rrudhë,  
sikur në jetë të kishit veç gjëzime;  
ajo e qeshur që gjoksesh niste udhë,  
kaq lehtë tretet, vallë, nga zemra ime?!

Po ç'të harroj më parë nga ai vend,  
ku zemrën në mes zemrash pjesë-pjesë e ndava;  
pas meje do t'ju ketë ngaherë ndër mend  
e mira dhe e shtrenjta vajza ime Alba!

Mikpritjen tuaj, besën me aq nder —  
do t'i kujtoj sa kohë të kem jetë;  
e syt' e mi  
              mbi ty do çlodh ngaherë,  
«O nënë e ashpër e burraye të rreptë!»

Ndoko tam qumella qe kri mirekav i  
qumella qe mirekav qe sun salom qe  
qumella qe sun salom qe qumella qe  
qumella qe sun salom qe sun salom

ELENA GJIKA sinj. Sinj. qe mirekav i  
ELENA GJIKA sinj. Sinj. qe mirekav i

Sa i donte këto brigje,  
nuk i ndau nga gjoksi kurrë;  
tek e kujtonte vendlindjen,  
dallg' e mallit merrte udhë...  
ELENA GJIKA sinj. Sinj. qe mirekav i

E vatanit luftëtar,  
me njët zjarr të parrëfyer;  
atë natë gjëmimtare,  
t'a largonte që nga kryet.

...Tek përpiq ato qepalla,  
tjetër nur i mirrte balli;  
ç'lezëte i kishte fjala,  
shkrepte çika si stralli...

Ata syt' e saj tē bukur,  
rrezëllonin ç'kish nē xhan;  
kur shih kopshtesh ndonjë flutur  
malli prap' niste revan...

Nëpér harqe vetëtimash  
syr' i saj prapste stuhitë;  
kësaj toke çerdhe trimash  
ç'i këndonte me gjith' shpirt.

— Motrat, nënët shqiptare,  
s'njohin frikë e s'thyhen kurrë;  
janë tē mbrujtura me halle,  
s'ka rrebesch që t'i përgjunjë!

Ç'deli trime nē dallgë shqote,  
mes betejash+ballyber;  
...Kjo penë që vjen prej Shkodre,<sup>1)</sup>  
tulipanë nē shpirt më çel!...

---

1) Më 1881, treqind nxënëse shqiptare nga Shkodra, i dërguan Elena Gjikës (Dora d'Istrias) një penë tē argjendtë, punim filigrani i mjeshtreve shkodranë.



## SHQIPONJA E SHKREPAVE

Si rrufe që s'ndalet udhës Col Delia<sup>1)</sup> kërkon  
shqepur hekurat e kullës, flakërimë nëpër flakë...

Sulm' i shqipeve me gjëmë, tymi po përpinte retë,  
me vëllezërit njësh u bënë mitrovicasit me

fletë.

Një nga një u lidhën varg shokat<sup>2)</sup> e brezit në  
kullës iu qepën përqark gëgħysen asit më shkallë.

Col Delia krahë-forrë, bubullimë dërrmon  
thyen hekurat me dorë, s'ka pengesë ai të  
sprapset.

— Ndal, Col, pse s'di të ndaluar?! Të jap pare  
dhe ofiqe,

jetën ty ta kam tē falur, thuajmë ç'do, sa don  
çifligje?!

Si furtunë që s'di pengim Coli zien gjoksit llavë,  
mareshalit ngjethur drithmë tej dritares i hedh  
fjalë.

— Të ka rënë çehre e ligë, mos bëj kot be e  
rrufe,  
gjersa vdekjen s'kemi frikë, tjetër frikë nuk ka  
për ne!...  
Ne në sy vdekjen e shohim se lirinë e çmojmë  
shumë,  
në vatan zemrat i ngrohim, ç'ka se kjo kullë s'i  
ngroh kurrë...

Syri ynë s'u drodh njëherë, shpatat tonë dritë  
ndritin  
ne për dritë kemi lerë, për atdhenë vetëm lindim!  
...O ju grunjëra mës brigjesh, për ju malli ç'do  
më marrë;  
vreshta, ledhe edhe shtigje, kodra, lugje behur  
bar...

1) Trimi 28 vjeçar Col Delia, nga Tropoja, vërsulet në  
kullën e Abdulla Drenit në Gjakovë tok me kryengritë-  
sit e tjerë shqiptarë dhe u vë zjarrin fuçive të barutit  
tok me municionin, duke djegur në këtë zjarr ministrin  
turk, pashallarët dhe krerët feudalë të tradhtisë.  
2) shokat — rripa mezi të gjerë që përdoren nga malësorët

Lëngon tërë perandoria, kalbur palca në pushtime,  
përmbi kurthe e hordhira ngrihet këng' e tokës  
sime!  
Plag' e gjak-Shqipëria, synë në dritë, dorën në  
kamë,  
kali ynë lëshon shkëndija, kal' i tyre ësht' në  
grahmë...

Kënga jonë, drithm' e jetë, këto brigje ka jatak,  
erë malesh që hynë vetë më çdo ledh e për çdo  
prag.  
C'kanë lezet këto luadhe me aromën që s'e sosin,  
bien zile e çokane, lulëkuqet zën' e lozin...

Rrjedhin gurrat ndër çetina, kënga jonë harlis  
dhe retë,  
një lahatë gëzon luginat, brof një valle si  
tërmët...  
Kemi një qiell të bukur, sado me diell të  
vrërët,  
duan malet jetë të lumtur, ndaj strall shkrepin  
në thembër...

...Brofi toka arbërore, ra një kullë me rrukullimë;  
zjarr' i luftës popullore dogji flakësh tradhtinë.  
Mbi një varr gdhendur në gur fryn një këngë tok  
me zefirin,

trimëria nuk shter kurrë, ja dhe pushka në dritë  
syri...

Geghysenosit me radhë vesën çdo mëngjes ia heqin,  
tyta ndryshk të mos marrë, thep e shqekëz t'i  
feksin...

Rrasa ka në majë një brimë, mes saj sheh si me  
dylbi,  
tyt' e pushkës atje hyn, i thonë «rras' e Col Delisë».

Dhënë vendim n'log të kuvendit, pushk' e parë  
këtu të zbrazet,  
bij' e bija të këtij vendi sot aty provojnë armët.

Gurrat gurgullojnë zallit, hapur grigja nëpër pllaja,  
pa u ndalur shqipja e malit i rreh flatrat lart ndër  
maja...

shih, tif u dënde se sib që vrasit e kësaj dhim, shëndet  
dhe...

niveli si anëtare obq. mës zbulben om. themave gjatë  
i c'loprie s' qëndti dhuratën përm. si shtesën bën  
vendos.

## TRIMAVE U QESHTE YLLI...

Rrapo Hekalit

Sytë ç'm'i qesh një drit' e bardhë,  
mbrëmja tej merr të vaisur;  
hop e hop nëpër çdo majë,  
trimat xhamadan qëndisur...

Sokëllin Rrapo Hekali,  
bejlerët ç'i zu të gjallë;  
nga përpjekja tundej mali,  
hasmi kokëvarur nën pallë.

As u trembe, as u tunde  
Rrapo-rrufe me rropamë;  
plumbat të nduknin mbi supe,  
ti me supe mbaje malë!

Klithm' e huaj çirrte shtigjet,  
trimave u qeshte ylli;  
në të kuq shkëlqenin brigjet  
tek nxirrej shpata nga milli...

Prap' buron isua e valë,  
puth tarracat gjith' stoli;  
rri çdo gjoks-Rrapo Hekalë  
dhe çdo sy

sy pushke rri!

Prap' buron isua e valë,  
puth tarracat gjith' stoli;

rri çdo gjoks-Rrapo Hekalë  
dhe çdo sy

Prap' buron isua e valë,  
puth tarracat gjith' stoli;

rri çdo gjoks-Rrapo Hekalë  
dhe çdo sy

Prap' buron isua e valë,  
puth tarracat gjith' stoli;

rri çdo gjoks-Rrapo Hekalë  
dhe çdo sy

## IDRIZ, — LULE TRIMI...

Gjirokastr' e gurtë, e gdhendur-kështjellë,  
plumbat mban në futë, valle-fustanellës...

Pushka edhe pena ballin ç'ta qëndisi,  
çlodhet te bedenat kapiten Idrizi...

Dita krahët hapi, ajo dit' nëntori;  
eh, koh' e satrapit, regjim' i Zogollit.

Shqiptarët si lisa, Ditën e Flamurit,  
faqe tradhtisë-s'luan kup' e gjurit.

Turma derteplotë me gjëmim nga shpirti,  
kur, një zë i fortë «Poshtë kusarët!» briti.

U drodhën xhandarët, xhandarët e hurit,  
pa shkrepi një ballë, ball' i Idriz Gurit...

Ja, me dorë në shpatë, sharpën të përskuqur,  
çante me sy lart ai ball' i bukur...

«Kapiten Idrizi, dorëzoje shpatën!»  
Fap! ia bëri syri që fekste dhe natën:

— Hiqmu sysh, major, mor gjidi kopuk,  
ty me një tabor të ngul mu në furkë!

Zverdhur gjer mbi hundë ti nxiton i dirsur,  
jam nga tjetër brumë, jo dhi e gremisur!...

Ç'kroje kam pirë unë, nga ta dish ti,  
i hap pallës punë tek vjen gjith' stoli!...

Nuse me pahir që sot të hormis,  
ty, o ditënxitë, n'atë botë të nis!

...Zbret serbes nga kali, shpatën vë tek milli;  
Idriz-jehonë mali, Idriz-lule trimi...

## SEFË KOSHARJA

E kam zemrën kaq të valë,  
fërfëro, moj erë, mbi lis...  
Këto brigje ç'nur më kanë,  
s'reshthin trimat te ky fis.

Moj Kosovë që s'e ul synë,  
më ke bir e të kam nënë!  
S'ka të shtetur zjarri ynë,  
e mëkojnë-o ç'deli këngë...

Prap' do vij tek ti çdo verë,  
për t'u çlodhur nëpër hije;  
gjoksit zile do më bjerë  
malli për këto korije...

Ndaj dhe të më ndajnë çika,  
prap' do ngrihem pér vatan;  
vallë, i vihen detit prita?!  
Shuhet me ujë një vullkan?!

Dhe pa duar, dhe pa këmbë  
do t'ia marr shtruar me shokë;  
shpatën do mbërthej me dhëmbë,  
betohem: «Pér këtë tokë!»

ativ pat riq ezikëg zëqëz  
lomtëtov jumz bja tub  
oliz olaq lirat fit qfisx o  
zecimtar ljosel pa dax bja

Bandib si aqoi oan sësimqell  
i qelli n'ta yi allaqip wa  
tash... Sësimt qëllit imri ës  
si i st allud idur qan dolë

qëllid e lëtq bja et ejsëm  
i lloq thunçet agit qëll që  
qëllësimt qëll mësor  
qëllura parë e qëllura që

## BALILO, BALIL NURI...

Nëpër gërxhe pér kaq vite  
dot s'të zuri vetëtima;  
o sorkadh në maj' çdo gryke,  
ç'të kish aq lezet martina...

Topçinjtë me topa ta dhanë,  
po qepalla ty s't'u dha;  
të mori flaka fustanë,  
ç'deli nur mbi ballë të ra...

Ndënje te një pllak' e bardhë,  
ujë pive nga paguri;  
kokën ule dalëngadalë,  
pa kuptuar u skuq guri...

Tej, tek lisat në luginë,  
rrezet hodhi buz' e mbrëmjes;  
ngyjer guri kuqëlimë,  
ç'i lëvrinin barit rrëmbat...

Të griu maj' e cfungjisë,  
shkëmb a çishe, o ëbalil?!  
Përmbi shpatull e nën sisë  
shkrepje prush a gjak të dil?!

Mbi një këngë të trimërisë  
ra të clodhet pakëz palla,  
ajo lulja për nën sisë  
çeli burbuqe të rralla.

...Ja, nga mendja nuk na hiqet  
Balil-nuri ballëdritë,  
Balil Nivica me tirqe,  
luftëtari sypetrit...

I thosh' nëna zemërjarr:  
— O Balil, ç'mi bëre lotë?  
— Pikë-pikë, po aq të valë  
i derdhe, moj mëmë, për shokë!

Kaq taborë merr e jep,  
s'të gremisën kurrë ty;  
ballégërvishturi në cep,  
mu tek vetulla mbi sy...

Supeve flokët të shpleksur,  
gjoks' i hapur, gjëmim thellë;  
mbrëmja në yje e ndezur  
të prehej mbi fustanellë...

Kur nxitoje bregut çapat,  
shpata shkrepte rëndë-rëndë;  
hyje shpejt nëpër baladat,  
që i tirte toka mëmë.

Trokëllin potkoi kalit  
si shkrepëtima buz' llohës;  
mjaltë rimash ndër balada,  
thurje në tezgjah të kohës...

Me atë mallin e birit  
priste për çdo darkë Nivica:  
Balil Nezha, lule trimi,  
more Balil Këndrevica...

...Një pres' shpate gjith' lezet,  
përmbi vetull prap' të rri;  
në cep buze zë e feks  
malli yt pér shokëri...

Kur në tokën mëmë u ngule,  
e puthe dheun me mall;  
në gjoks të rrinin si lule  
më shumë plagë se vjeç

në ballë!...

në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...

në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...

në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...

në ballë!...  
në ballë!...  
në ballë!...

## MERR TE ÇLODHUR NËPËR VALLE

*Heroit të Popullit Ismail Qemali*

C'mendime mbi vetull heq 'tek vështron shkëmbin  
  mbi dallgë?

Dhe mërjisë i vjen keq për t'u ulur n'atë ballë..

Ja, kjo mbrëmje gjith' lezete përmbi Vlorë po zurret  
   ngadalë,  
ti buz' shkëmbit rri mbështete, deti zë e qeton  
   valën...

Suferinave përditë, udha jote shqot' e dallgë,  
kur i mylle sytë, ullinjtë ç'i tundën degët me  
  mall...

Pranë ua ndjeve fërfërimën, deshe t'i lëmosh me  
   duar,  
diç fole në mërmërimë larg e buzëpërvëluar!...

— Ky vatan ka peshë të rëndë, sado lehtë që fryn  
zefiri,  
gjakësht' larë me deg' e rrënje, as pëllëmbë të  
mos lini!

Po lëshuat dhë një fije, s'ka si gjej prehje në varr,  
do më luaj gur' i kokës, çikë-çikë do plas ky  
xhan!...

... Ç'do kem mall përkëto majë, këto majë ngjyer  
borë,  
kur zurret mbrëmja përmbi pllaja, ah të ngrihem  
t'i vështroj!...

... Vjen sot pamje krejt i thinjur, dritëbardhë vë-  
shtron mbi male,  
fjala «lodhje» të ngjan hidhur, merr të çlodhur  
nëpër valle...

## MOTIVE NGA JETA E RE

### QYTETI I MINATOREVE TË MEMALIAJT

Faqe diellit dritaret,  
e pi gjirin thellë nëntokës;  
nga tre anët vetëm male,  
në hark Vjose i kreh flokët...

Lufta palcës së nëndheut,  
biografi që rrjedh ndër dejë;  
mademi q'i jep atdheut  
prush e dritë për vrull betejë.

Me ballkonet karshi pusesh,  
gjelbërim ndër ledhe, kodra;  
mbrëmja përskuq lisa, dushqe,  
s'njeh veçse mëngjes nëntoka.

Dy binjake-djers' e këngë,  
si dhe Vjosa, s'dinë pushim;  
një kronik'me peshë të rendë  
dhe për brezat që do vijnë.

Thinjen njerëz po s'ka plakje,  
zemrës malit - gjokset male;  
nga mëngjeset fshatarake,  
nëpër ditë industriale...

## ZEMËR E RINUAR

Mbi shpatull mali bardhëron ky fshat,  
sa çel dielli synë, çatitë zën' përskuqen;  
njëqindepesëvjeçar

përditë ecën një plak,  
nja katër luftëra i ka hequr supesh.

Mos e mendoni të dremit' mbi zjarr,  
mëngjes e mbrëmje e gjen nëpër parcela;  
ai që të sjell para historinë e gjallë,  
në pikë dimri del të mbjellë pjergulla.

— Djalërinë e shkova kaçak-suferinë,  
më tëhu, vumë flamurin në Vlorë;  
më ka bërë nishan plumbi mbi brinjë  
në dyzetetreshin-korrier në bašalion,

Po ndriti dita e bardhë e lirisë,  
unë argati iu bëra dheut zot,  
mëngët i përveshë krah' rinisë  
dhe asnje çast s'i ula gjer më sot.

T'i rrishë te koka punës, jo vërdallë,  
të të pikojë në shpirt dhe për një gjethë,  
nuk ësht' kushedi se ç'trimëri e rrallë,  
gjersa kemi frymë e  
s'rrojmë vec për vete...

Pata këmbë të lehtë, s'më mbahet hapi,  
më hanë gjunjët prap', ndaj ngrihem pa gdhirë;  
qysh kur u bëmë Parti  
m'u kthyë vrapi  
e qejfi nuk ma ka zvarrisjen; more bir...

## NËNAT

Ndër mote të pagjuma  
diçka ju thoshte zemra,  
o nëna derteshuma,  
ju nëna plagërënda.

S'e mbanin dot as malet,  
të thellën dhembje tuaj,  
ç'ju zbardhi një lumë hallesh,  
ju dukej dita muaj...

Dhe njëqind plagë të merrnim  
për ju nuk reshtë malli;  
kjo botë s'ka mbi refrenin:  
«Nënë, o moj nënë xhani!»...

Ky gaz c'ju ñdrin kështu,  
o nëna zemërbardha;  
kush di t'ia thotë si ju  
me ligjet më të rralla!...

### SHALLOVËRËSHE

Shallovërvëshestë, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë

Shallovërvëshestë, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë

Shallovërvëshestë, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë  
nëpër qytetin e tij, qëndroj me vërtetë

...ntifësi nish a m'lo sot që  
...zartibrodi është e sot që  
...n' i ka ftojtë sot i ka ftojtë  
...n' i ka ftojtë sot i ka ftojtë

## MBRËMJE PRILLI

Mbrëmje e qetë me hapa nga ndonjë sorkadhe,  
me zëra laureshe ulur përmbi gur,  
blegërima të lehta ndër brinja e luadhe,  
avaz' i bulkthit që netve s'resht kurrë...

O qengja, që pa u lodhur hidhi e hidhi,  
ju këngë, eh... ç'këngë bilbili gjith' mall  
ndërprerë nga isoja e qyqes majë vidhit,  
ç't'i përmendësh kësaj mbrëmjeje më parë?!

...Një dritare hapur me pamje nga çairi,  
diç presin dy sy të bukur asaj udhe;  
nis gérhet traktori në këtë mbrëmje prilli,  
po kullosin qetë të lodhur pas pune.

Shushurimë burimesh honit a në shpat  
mes zërit të culës nga çobanë të pagjumë;  
që larg hingëllima mëzash harrakatë,  
o vende të dhembshura,  
ç'ju dua kaq shumë!

## SHQIPËRISË NË PËRQËSHIRË

SHQIPËRISË  
NË PËRQËSHIRË  
SHQIPËRISË  
NË PËRQËSHIRË

SHQIPËRISË NË PËRQËSHIRË

SHQIPËRISË  
NË PËRQËSHIRË  
SHQIPËRISË  
NË PËRQËSHIRË

SHQIPËRISË NË PËRQËSHIRË

SHQIPËRISË NË PËRQËSHIRË  
SHQIPËRISË NË PËRQËSHIRË

## VELLAI PO MA VONON NËNËN

Nënë,  
më piku malli, nënë;  
malli për nënën  
e malli i nënës...

Si ai e s'ka tjetër.

Po s'erdhe dot,  
në dy gisht letër,  
qafomë me atë fjalën

«Bir...»

C'të them më tej?!

Nënë, o nënë,  
ti më kupton aq mirë!...

## L U K O V È

Dheu pi nëpër damarë  
ujë që shket mbi çdo pëllëmbë;  
firmë rinie mban çdo shkallë,  
djersa e saj nëpër çdo rrënje.

Pa, kur ledhet puth veriu,  
mbi çdo gjethe vjen një flutur;  
gjoksi të gufon vetiu,  
zemra të thotë: — S'ka më bukur!

Dje veç ferra edhe harca,  
sot blerimi anë më anë;  
këto kodra me tarraca,  
amfiteatër gjigant.

S'doli rastësish t njetë,  
s'çau me prehistorinë,  
kryarkitekte vëtë —  
koha që lindi Partinë.

Rrinë limonë e portokalle  
mes lulëzimit «spektatorë»;  
ullinjtë ia hedhin një valle,  
vallen e rinisë sonë...

Qëndrësi i vjetër i qytetit  
i dëmtojët oby idha mëdha që së putojë  
sillëtë oby dëmtojët qëndrë  
shumë oby dëmtojët qëndrë

qëndrë dëmtojët qëndrë  
i dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë  
qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë  
dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë

qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë  
qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë  
qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë  
qëndrë dëmtojët qëndrë dëmtojët qëndrë

ALBUM ALEM DUTOM  
BIRU MEL QUAGHIDAH

## NË QYTETIN TIM

MUSICA: G. S. T. / LYRICS: G. S. T.

Esht' natë e pastër e qielli pa anë  
po fle n'oqeanin e syve ëndërrimtarë.

Rrezja e hënës, mbi këtë truall larë dritë,  
përzë nëpér hone hijet që larg treten;  
ajo i vështron me syrin e florinjtë  
çiftet e vonuar tek'i gëzohen jetës.

Në qytetin tim u mbyll dhe port' e fundit,  
i pasmi harrakat u kthyen nga takimi.

Oxhaku i fabrikës që larg gjith' nxitim  
si gurmaz gjigant gërhet me gulç parështur;  
avaz' i njëjtë notash basi pa mbarim,  
pret e përcjell njerëz të qeshur...

Qyteti fle edhe dremit nga turn' i natës  
që nesër dita të jetë edhe m'e bukur.

# MOTIVE NGA LUFTA NACIONALCLIRIMTARE

## 1. NET GJEMIMESH

Era

retë ia mbledh kruspull motit ngjyrerendë,  
tufani kryenec përmbi bredha krekoset;  
me bërryla mjegullat i praps tej një nënë,  
koll' e saj mbi ledhin e yjeve soset...

Djemt' e popullit gérxheve si sorqedhë,  
gjer në sy të gjurit të ftohtit e pinë;  
nëna —

iso majave pret edhe përcjell,  
yjet larg kanë shumë të mërdhirë...

Nis i paket hënës mes vrapi

prush' i bardhë i zemrave  
drit' e verdhë,  
ngricën zë ta shkrijë...

## MALI U PA NË PASQYRË

*Heroinës Bule Naipi*

Mbi çatitë vështroi qet',  
vështroi kalanë karshi;  
dolën sofatesh anetë,  
pa e puthnë sy më sy...

Si s'iu drodh ai qerpik,  
në zinxhirë, po syrin drejt;  
n'ata sy ç'i ra një dritë,  
nga litari s'pati dert...

Krojet ránë në mërmërimë,  
rrahu shqipja nëpër maja;  
ndien kaldrëmet drithërimë,  
isua ç'i mbuloi pllajat...

— Do ta marr edhe një këngë  
për këtë qytet shkëmbor;  
s'tunden trimat te ky vend,  
Çelot dhe malet me borë!...

Ja, po ndizet, tej, një yll,  
Mal' i Gjerë shkrep vetëtima;  
dhe kur sytë e mi të mbyll,  
prap' do djegë barut vendlindja.

Era ëndrrën ma përkund  
gjer ta fitojmë lirinë;  
kënga ime nuk ka fund,  
Gjirokastër, lamtumirë!

Kalanë dhe një herë vështroi;  
iu çel nuri mbi ftyrë;  
ballin malit ia drejtoi,  
mali u pa në pasqyrë...

Nisi shushurimën zalli  
mes rrëkezës që po ikte,  
Argjiro mbi lava zjarri,  
ç'deli bijë e bija rrite!

— Nëpër këtë gjë, po ngrënë, po shkrep, po qetë  
shiu kaq i rëndë, pérrenjtë të sertë...

— Zbathur e pa ngrënë, me ditë e me net,  
shiu kaq i rëndë, pérrenjtë të sertë...

**MALET KRAH' I KEMI...**

— Gjermani, mizë lisi, dhe me shumë takëme,  
bij, të paktë më jini në mes kësaj gjëme...  
— Pse kështu, pareshtur po shkrep nga çdo anë?!  
Dy dimra të egër tej tre partizanë...

Zbathur e pa ngrënë, me ditë e me net,  
shiu kaq i rëndë, pérrenjtë të sertë...

— Gjermani, mizë lisi, dhe me shumë takëme,  
bij, të paktë më jini në mes kësaj gjëme...

— Nënë, vetëm s'jemi, shok' e shoqe plot,  
malet krah' i kemi, e dhembshur kjo tokë.

Tejepërtej dimrit ne ecim përpara,  
të mos flenë fëmijët në qefin të bardhë.

Shkrepave të larta me ty pranë gjithmonë,  
na jep vrull çdo hap, nënë, o nëna jonë!...

— Djem, se ç'më gëzuat, zemrën e ndiej valë,  
nesër do t'ju zgjoj që me yll të parë...

Hapur kjo kasolle nëpër flakë lufte,  
eh, kjo bijë llohe ç'ju rëndon mbi supe!...

## BALADA E MULLIXHIUT

Cëk-çëk, gjith' jetën veç me një çekiç,  
guri i mullirit dhe çekiçin griu.  
Kush, vallë, paska thënë se jeta ësht' hic?  
Bloj edhe hekurin mullixhi Haxhiu.

Me miell ngaherë pudrosur i téri,  
si shkum' e elikës shpirt' i tij i bardhë,  
kushedi sa gurë të mullirit gdhendi,  
kushedi sa iso

mbi prehër i ranë...

Kur thirri atdheu hodhi një pushkë krahut,  
ngjeshi gjerdanin fshehur nën tepsi;  
pas çdo beteje e mirr malli për vahun,  
mendjen edhe flakëve

e kish në mulli.

Barut trazonte e shpesh kujtonte miellin,  
i ngrohej dora e i gëzonin sytë,  
me vete thoshte: — Mbron baruti diellin  
tek del mëngjesit

e mullirin mbush dritë...

...Zbardhi dhe dita e pritur aq shumë,  
pjek mullixhi Haxhiu kulaç në vatër;  
mielli mund t'i lagej, bäruti-kurrë,  
buzagaz ai, por dhe me syrin katër!  
  
Në ditët e gushtit, kur i pakej uji,  
çëk-çëk çekiçi, një avaz mbi gur.  
...Plepi një mbrëmje majën pak përkuli,  
iu prenë Haxhiut gjunjët te vahu mbi ujë...

Vetiu lugu qetoj befas rrjedhën,  
ndonëse në vrap s'reshti rrot' e mullirit,  
synë e diellit e pa edhe një herë,  
çekiçin pranë qasi

e qeqallat mbylli...

## KUR BIE PËR ATDHEUN

Mos quditi pse marr këngë,  
më të lehtë sikur ndiej gjoksin;  
dhembja ime s'ka më rëndë,  
po nuk shkon për trimat loti.

Këngën, bir, e kemi ligj,  
më të lerë çoc qajmë pak;  
kush me gjoks i theu armiqtë,  
pas çdo plumbi leu prapë.

Qoft' kur vdesim, qoft' të gjallë  
s'hyjmë të gjithë në këngë dot,  
po mbi këngët gjendet vallë  
tjetër gjë të rrojë në botë?!

# KJO DASHURIA JOTE

## 1. KUR VIJE TI...

Kur më vije ti te'bzë e fushës,  
era loz e loz me shaminë e gushës...

E shkele ngadalë fletën e tërfilit,  
me vete rrëmbeve zërin e bilbilit...

Të hutuar zogjtë pyesnin me ciu-ci.  
— Buzëqeshin lulebajamet  
    apo ti?!

Flladi ndali pakëz hovin n'ato vënde,  
ra në byzylykun  
    e bukurisë tënde...

## 2. KJO DASHURIA JOTE

Mbi tokë ka lule me erë e bukuri,  
që dielli i puth me gaz e dashuri,  
po lulja m'ë bukur që më deh me aromë  
në çelje petalesh për mua je ti.

Ja, ky trëndafil që mbi gjith' lulet dua,  
nga faqja jote e merr ngjyrën hua;  
aromë e vesë prej frymës sate merr,  
model për petalen ka buzët e tua.

Rreze drite vrulltas ngado shtigjet shkrepën,  
sa për kahasim s'më lanë kohë të gjej tjetër;  
me ty gjoksi im gufon pareshtur mall,  
kjo dashuria jote gaz ma mbushi jetën.

### 3. DETI I FJALËVE DHE PRUSHI I PUNËS

— Kur do vish, moj, as më thua,  
shtatlekundura pahua?  
Sonte prap' do mbartim duaj,  
ç'te kam bërë që s'vjen me mua?!

...Syri sikur t'ur trishtua, e nuk jep qetë  
balli yt u zemërua, e nuk jep qetë  
buza jote po tankohet, e nuk jep qetë  
faqja zjarr tē përvëlohet...

— Ke marrë vrap, o mor i shkret,  
nuk i mat fjalët që flet, e nuk jep qetë  
pa'i nixjerre ato që the, e nuk jep qetë  
unë ta bleva ç'mëndje ke,

— Kot ti mban mëri me mua,  
se e di sa shumë të dua;  
të këmbej ca fjalë me ty,  
s'ësht' hata a kushedi...

Rrojnë bota sy më sy, i OA IA.  
pse kështu për ne të dy?!

— Mirë, mór djal', këq nuk thua  
po... këta duaj diq duani.

Vetëm fjalët

kë gëzuan?!

— Nëse këtë gjë është vërtetë  
dëshironi që këtë gjë  
të bëj, t'kemi qëndrim  
të vënë së shpejtë.

— Nëse këtë gjë është vërtetë  
dëshironi që këtë gjë  
të bëj, t'kemi qëndrim  
të vënë së shpejtë.

#### 4. AI DO MË VIJE...

Faqe mollësh puth· buzë e erës,  
degëzat e tyre njom vesë e butë;  
çlodhet vajzë e bukur ndanë parcelës,  
i rri pjeshka mbi kokë, një kokërr këput...

Gjintë e vjeshtës fruta mbushur plot,  
po edhe shqetësime sillka vjeshta.  
— Ai do më vijë! — zemër e vajzës thotë,  
pse aherë  
                dyshoka kjo pjeshka?!

Thyhet dita ngjyer nëpër mjegull,  
syt' e kaltër tutje bëjnë udhë;  
u ngrit një gushëkuq, u ul një vetull,  
mes një melodie  
                qeshin dy palë buzë...

## **5. KTHJELLTËSI**

Sa herë, e dashur, nxitoj të vij te ti,  
diçka si hutim ndofta ke vënë re...

S'resht duke vështruar ata sy!

Kthjelltësin' e zemrës shoh atje,  
pastërtinë e shpirtit gjej aty.

## O R A

Tik-tak,

ndaj gjithçkaje iindiferente,  
nuk pyet per endrra,

dashuri,

vdekje.

Per një gjë ngaherë e kujdeshme,  
tik-tak,  
tek nã kujton kohën  
që ikën e më skthehet.

## NËNA IME ME SHTATË NURE

Gjersa trima rrit çdo prag,  
nga kjo vdekje nuk ndiej rëndë;  
veç s'më shkulet një metak,  
e kam dert që s'pashë dët nënën.

Çikë-çikë më la fuqia,  
plagënjomi më çdo anë;  
do më rriten vet' fëmija,  
po s'iuh ndodha nënës pranë....

Nëna ime kock' e fortë,  
hasmin ndien qysh në kufi;  
as më lajka, as me top  
s'hyn në kurth e s'di bëli!

Kush s'e njohu atë nënë,  
me hanxharë e me sëpata;  
rrudhat i ka ca të rënda.  
po nga balli feks dhe nata...

Mban opinga prej lëkure,  
nën jelek thik' e hurorë;  
nëna ime me shtatë nure  
di aq këngë, ç'di t'i këndojet!...

Ja, e ndiej... nëna te porta,  
mban tezgjahun e dëgjon,  
valles do ia marr me hopa,  
syr' i saj sa më gëzon!...

Erdha, nënë! S'më lanë pritat,  
dot s'u çmallëm, larg gjithmonë...  
Pa për djemtë do m'i rrit  
lakra dhe lëpjet' e njomë!...

## NJERIU I VOCKEL

Poezia, arti, pallatet, köto male,  
kjo dritë që na çel sytë e skaj pa ndritur s'lë;  
turbina, shina, oxhaqe, brezare,  
nuk mund t'ia bëjnë atij të qeshur jetën.

Ndonëse s'i mungon gjë,  
s'e kënaq, asgjë, ai sheh e dashuron vetëm vërveten.

## BILBILI DHE PALLOI

Atje te një ledit<sup>ku rrjedh e rrjedh</sup> një krua,  
bilbilit iu ndodh pranë papritmas një pallua.  
*(Të vënët që t'është)*

— Ti qenke kaq i vogël, singjakë hiç me mua,  
sado që s'i këndon fort keq këngët e tua.

Më shih<sup>sai</sup> bukur jam, shihmë edhe thuaj,  
tash që ne u njohëm, të më ngjasësh duai...

Po lype dy-tri pendë, t'i jap qysh sot hua,  
mbase gjej sekretin se si duhet kënduar!...

— Më mirë... ti mba fort ato pendët e tua,  
nga borxhi i përfolur, cili u gëzua?!

— Fundja... t'i fal fare, mos e merr nxituar,  
dy-tri pendë më pak nuk ka se ç'më gjen mua...

— Më sëmbon, or mik, ajo... «të më ngjash dua»  
e, zërin tim.

nuk e di  
e s'ka si ta jap hua!...

## ZĒRI QĒ GJĒMON

*Punëtori Harri Petti në periferi të  
Çikagos thirri «ndihmën e shpejtë»  
për gruan e tij shtatzënë, por meqë  
ai nuk kishte të paguante 42 dollarë  
në dorë për transportimin e të së-  
murës, makina e urgjencës u largua.  
Pas disa orëve e sëmura vdiq.  
Nga shtypi*

— Jam zër' i fëmijës që s'erdhi në jetë,  
një zë krejt i kobshëm, i mjerë e i ngjirur;  
do të doja ta shfreja gjith' dertin vetë  
për xhelatët që më gllabëruan qysh pa lindur.

— E njomëza foshnjëz!... U sulën mbi ty,  
të mohuan të njohësh nënën, atin tënd...  
Ju, njerëz në botë, e ndieni ç'mizori?!  
Shpirti na këlthet e gjoksi thellë na dhemb.

...Paskan qetësi nga zëri ynë i mjerë  
një grusht prej magnatësh që pijnë gjak tjeriu;  
klithma jonë — kambanë do gjëmojë përmes tmerrjt,  
o grua, që mosardhja e foshnjës të përpiu!...

— Unë... ika, Harri im. M'u bë gur krejt gjaku,  
nuk e pa diellin foshnja që s'na leu;  
po, më thoni, oh, thuajmë ti, së paku,  
Statuj' e Lirisë

pse s'ngjyhet  
ngjyrë dheu?!!

## KUR I ZË BESË PABESİSË

Për dhelprën dhjetëra fabula janë shkruar,  
gjithkush ia njeh vesin, dinakérinë;  
si duket, ajo vetë s'i ka mohuar  
gjersa udhë nuk ndërron e as e prish terezinë.  
Një tjetër histori do t'ju rrëfej,  
për dhelprën e veçantë, jo si të tjerat,  
kjo s'njeh ves e dredhi, as të gënjejë  
e pulat bën sehir dhe hapur po qe dera...

Njëherë u gjend papritur pranë kotecit  
dhe, që të ndahej paq, shfaq një mendim:  
— Erdha ashtu, kot... Diç në grykë më ngeci  
po, që ta njihni mirë ju shpirtin tim,  
ja, më lini këtu sonte që të flë,  
gjith' natën do bëj rojë, me pulat tok;  
do t'ju përgjigjem unë nëse i gjen gjë,  
motër jam për to, gjelin e kam shok.

Habitur krejt tē zot', i zunë besë.  
Si kyçën mirë kotecin u larguan;  
ra nat' e errët e hëna me përtesë  
që prapa reve shtyhej e menduar...  
Pa vrarë mendjen shumë kjo zonja dhelpër  
nisi nga avazi, si zakon e kish;  
përtyp një pulë e shtrijë, një pulë tjetër,  
«Gjersa besë më zunë, do ta bitis...!»

Aty afër mesnate, kur s'desh më,  
ngopur barku gjer dhe për mbi mullë  
tha: «Tash buzët t'i fshij, gjurmë tē mos lë,  
ka dhe kufi kjo punë... Do bëj udhë!...»  
Po, një grackë tek dil këmbën ia zë fort,  
dhe qeni ç'iu vërsul, gati ta ndukë;  
«Më lër se... kam flethyryje nga tē zot!...»  
«Ndofta ke,  
po... ke dhe bisht tē bukur!...»

## NË VETEN TËNDE

Një gjemb shege zgjatej shpesh përmbi një ftua,  
pa ç'pa ftoi, një ditë s'iu durua:

— Mos harro se frytin s'e kam marrë hua!

Si të dhëmb në trup  
ashtu më dhëmb dhe mua.

## BIRI I MALEVE

*Heroit të Popullit, Mustafa Matohiti*

### I.

Cingërimë e ngrica në çdo hon e hap,  
zë harbohet era sa shurdhon dhe malin;  
shiu gjurmët fshin e fshin çdo çast,  
gjer në palcë të ftohtit rreh mbi komisarin...  
Marengleni mbrëmjes nxiton nëpër udhë,  
i pangrënë e zhveshur në këtë rrebesch;  
gjoks' i tij me kollë prapsje s'njohu kurrë,  
fry, moj erë, fry nëpër Kurvelesh...  
Ç'po rënkojnë strehët nga altet ndër rrugica,  
copëzohen katersh kërcitje bajonete;  
gjith' merak sa nëna (eh, nënët!) në dericëka,  
s'ka të ngopur e ardhmja oshëtima jete.

2.

Një jehonë këngë përmes natës sterrë,  
ç'e përcjellin radhaz përrenjtë shteg më shteg;  
gurët gishta këmbësh prekin herë-herë,  
me këpucët grisur ec e ec ndër net...  
Krakërin kallkani, ky shi s'bën rehat,  
brigjet mbytaz sjellin jehona gjëmimi;  
shkrofëtima honesh, shungullimë e gjatë,  
në mbledhje celule po shkon gjuhëbilbili...

3.

...Sikur lodhet shiu. Muçua prap' në udhë,  
sa një bojë njeriu bora, ndien ftohtë mali;  
dhembja për të rënët mbi ballë i sajon rrudhë,  
atij që tradhtarëve u ra në pres balli.  
Lemeri ngërthyer armiqjtë duan strofkë,  
fundi ngjyer turp i ndjek hije çdo hap;  
gjithçka përcëlluar rrafsh me tokën,  
digj e pushkato po, isoja jonë më lart!...  
Dritësuar bebëzat e nënave në përgjim,  
prit edhe përcill Marenglenin mes ngricash;  
thellë gjoksesh mbrujtur veç një shqetësim:  
— Këtë natë ku ndodhet e ku do ta zerë dita?!

4.

Përkarshi, buz' mbrëmjes  
po ecin dy veta,  
Ali beu-llagëmesh,  
Muçua që nga shkrepat...  
Në krah' i lëpihen  
beut nja njëzet;  
qerpiku s'i dridhet  
Muços vet' i tretë.

— Fol, bej, për zullumet  
që s't'i lan as deti.  
— S'jam kursyer unë,  
më njeh tërë mileti...

C'i polli bela  
beut, leh e leh;  
ngrefur pendët mba  
si kaposh mbi pleh...  
— Unë... veç për atdhe  
jetën e kam shkrirë...  
— Uli pendët, bej,  
zbulioje fytyrën...  
Shpirti yt si zgjyra,  
duart në gjak-lumë;  
bej me dy fytyra,  
bej me flamurë shumë!...

5.

Nëpër flakë llufitur çatitë ngjyrë hiri,  
po ndër zemra prush' i lirisë kurrë nuk sosi;  
buz' me mallin e nënave tek presin birin,  
lugu i maleve thith kollë nga lugu i gjoksit...  
Gjëmon Gryk' e Kuçit, vetëtin Zareli,  
guvat e Nivicës se ç'mbajnjë pakëz vesh:  
— Si s'u pre një çikëz koll' e Marenglenit?!  
Fry, moj erë, fry nëpër Kurvelesh...

...Dhe ecën bilbil Matohiti kokëlartë,  
lugjeve, ndër brinja, i paankuari një herë;  
në Delvinë mëngjesi, drejt Beratit në darkë,  
zemërhekur ai, ndonëse gjoksi i ther thellë...

Ja Qaf' e Gërxhunit tek ngjit të përpjetës  
me një halë në lugth, po i prerë për trimëri;  
ai që s'njohu prapsje qoft' edhe një çast të vetëm  
nëpër vapën saç a buz' shirash me furi.

## MALLI I SELAM MUSA SALARISË

*nga kënga e fundit e heroit*

Ç'kam një mall e s'e them dot, më piku për ato  
stane,  
të pi me grusht ujë të ftohtë, të vë kokën mbi  
llabane...

Memë Sherifi shumë më do, ç'm'u puth ylli që në  
fshat,  
po dhe unë, Memë biro, në flakë e mbi tela bashkë...  
Qysh do durojë shpirti im për ato bigat në rreshta,  
një çokane trokëllin për luadhe, lugje, vreshta...  
Ato biga që vërsulnim, kam sevda prap' t'i ngrë,  
këto duar qysh i shkulnin, mall i maleve më zë...

Ai mall që merr dhe gurët se ç'pikon që thellë në  
shkëmb,  
malli ynë thanë edhe drurët, pikë-pikë pikon e  
dhemb...

Eh, kjo erë që nga malet ç'po më hyn kështu ndër  
dej; hoqe, Memë, dhe ti kaq halle, lis i lartë lastarë do  
lejë... Mosh' e thyer, Memë, o bir, po një herë kam  
derdhur lot, tek ulliri me bërryl, ah ç'm'u vra një cmokthinqot...  
Ish një ditë më të aguar, në gjoks plumbi ç'ma  
goditi, buz' e malit u kuqua, ylli sipër majës ndriti...

Për të parë shokët kaq herë nëpër gjyle qysh më  
futej?! Predhë, plumb a çfarë të qe, veç me gjoks i prapste  
tutje... Ball' i bëri një duzine, kur jip frymë më çoi fjalë:  
— Prapa s'bëra një thërrime, të m'i thoni xha  
Selamit!... Dy pik' loti rrukullimë nuk i mbajti dot Selami,  
tejetej një thikë në brinjë, un' e di se ç'm'u dogj  
xhani!... Po ti, Memë, ç'ke në gjoks? Pse e mugullove ballë?!

...Ngrema edhe pakëz kekën, mos e cëno xha  
Selamë... Pike buzën se je burrë, në më do aq sa të dua,  
hoqëm tok rreziqe shumë po s'i kemi lotët sua!

...Më kujtohet kur një natë zbritëm lodhur te  
luadhi,  
zjarret ndezur përmbi fshat, ishte prill, ball' i  
beharit...

Na kish zënë hasmi pusi nëpër pyll afër një stani,  
me ca djem festen mbi sy, çape-gjatë dhe xha  
Selami...

Frrap! me vetull shkrepën çika ata çaknënët stanarë,  
ca me hunj e ca me thika, që të gjithë dyfEQELARË...

Ball' i bënин çdo të lige djemt e mi, o ç'djem  
levendë,  
po mbi ta një ëjalë Nivice, kapedan që kur kish  
lerë.

Gjithnjë krahut dy dyfeqe, sa e pyesje flit serbes:  
— Një për shokë e një për vete, do t'i mba gjersa  
të vdes!

U zu lufta përmbi majë, pall' e tij veç pre e gri,  
ç'i mori plumbi gurmazë, zemërborë si ai...

...Kur do marrim, o Memë, bashkë një sy gjumë te  
der' e stanit,  
kopenë të shkulim pas vase, të hanë majëzat e  
barit...

Çikë-çikë po zbardh mëngjesi, ja... i ftohën alitrikat,  
prap' në darkë do t'i ndezin, sa t'u thahet fare  
gryka!...

Ato drita që nga deti s'na i ndanë një çast ata,  
nëpër natën që s'u feksi, sharkut tim iu bënë bela...  
Gjysm' e sharkut mori flakë, gjysma m'u rop nëpër  
tela,  
nisi deti gjylet prap', na i bënë ullinjtë thela...

Pa për djemtë dinë të ruhen, u bën mali shenjë me  
kokë,  
ky pepinua që më mburret, ç'do i marrë trutë në  
torbë!...

Nëpër det do hanë shoshoqin, te ky breg me turp  
do ngjyhen.  
...Ç'ka Kanina që s'derdh topin? Mos m'u janë  
sosur gjylet?!

Dinë të ruhen djemt' e mi, le t'u bëhet copa guna,  
hasmi' erdhi lukuni, po strallli... s'qas-shushunja!  
Syri mjegull më ka marrë, ah ky tym ç'm'u bë  
bela!

...S'po më vjell Kanina zjarr, çoc do kenë, çokush  
m'u vra...

T'u jet' sosur gjith baruti? Mos ia ftohin grykën  
vallë?!

Vështro, Memë, ku shkoka plumbi, me dylbi do na  
kenë parë...

Mos e dridh buzën, o Memë, se më shumë do më  
pikë xhani,

shihmi djemtë sa më mbenë, thuajmu: — Rron xha  
Selami!

...Ç'ësht' i mirë për në vërrri ky qershori me gjethë  
shumë,

plumbat i bëjnë veri, po... ky tym ia prishi nurë...  
Më ra gjaku mbi këmishë, ballazi me gjeneralë,  
plumbi më ka marrë në sisë, po ia kam lavosur  
ballë.

Gjunjët vrapi m'i ka ngrënë që në Gribë e në  
Labovë,  
po do rrojmë prap' në këngë, në davete do  
këndojmë...

Nëpër iso buz' stralli këta trima prap' do vijnë,  
do vijnë djemt' e xha Selamit, që përgjunje gjëkund  
s'dinë.

...Hesht!... S'më ha baruti mua, së jam rritur në  
mes llohës,  
veç një plagë prap' m'u lëndua, eh, ësht' plumbi  
i Labovës.

Këto brigje si behar dëgjo ç'ligjërimë ka pylli,  
rrinë male, kodra radhë, te ky vend ç'të ngopet  
syri...

Netve një mall' i rëndë ç'do më pikë për  
Salarinë,  
në erë të shtrungës të flë, t'i heq udhë kopesë në  
brinjë...

Ndiej merak për një longar, e kam varur te një bli,  
kam një nipçe, deli djalë, do ta gjejë, kushedi...  
Për malet t'ia thotë çdo ditë, që llamburisin nga  
bora; dyfeku s'më njoihu ndryshk dhe në borë nën  
shark e ngroha...  
Ndaj çdo atdhetar ngaherë nipçja me shokë t'i  
kujtojnë,  
kur longarit të m'i bjerë, Këndrevicën të vështrojë...  
Ç'kanë lezet, ç'më pikon shpirti, n'ato lugje prap'  
do vemi,  
amanet, o Memë Sherifi, Salarisë të falat shpjemi!...  
Mbeçë mirë... Këngës ia shtro, vumë dhe dorën  
përmbi ballë,  
pikë loti mos loto! Hakën mos ma le pa marrë!

Ah, s'më iket... Se kjo kockë me strallë ësht' e  
gatuar,  
merre pagurin nën kokë, njomëm buzën e  
shkrumbuar.  
O ju djemt' e mi gaztorë, që nishan merrni aq  
mirë,  
ju që s'ma lëshoni Vlorën, gjylet i shtyni me  
brinjë.  
Dhe të fortë e dhe të bukur si këto vende stralli,  
mos më mbetë nishan e pluhur, po më shteri për  
ju malli!

Malli im nuk ka të sosur, o moj Vlora buzë deti,  
të kam pranë e s'kam të ngopur, buzë shkëmbit,  
ball' lezeti.

Telat i bëra dërrmile të vështroj valët e tua,  
po më futën në mendime ca pamporë... tjetër sua...

Tek ky prag nuk mbahet mend armët ne t'i  
ju, pamporë, dhoga u rëntë, ua thëntë mu në rrëz'  
të veshit!  
...Shih, o Memë, prap' ia nisën djemt' e mi  
— Hajde, djema, atë iso mu në gjoks do ta

mbërthej.  
Pa Selamë do ketë nga mot nëpër shkrepë dritëlara,  
dhe të mençur, dhe të zot, do bëjnë gjithnjë  
përpara...

## PËRMBAJTJA

### MOTIVE NGA VENDLINDJA

Çast mëngjesi në Nivicë .....	3
Te pragu i shtëpisë ku linda .....	4
Peizazh .....	6
Ura .....	7
Etyd mëngjesi .....	9
Fshati im .....	10
Akuarel .....	12
Dëshirë .....	13

### TRIMAVE U QESHTE YLLI

Në vratat shqiptare .....	14
Elena Gjika .....	16
Shqiponja e shkrepave .....	18
Trimave u qeshte ylli... .....	22
Idriz, lule trimi... .....	24
Sefë Kosharja .....	26
Balilo, Balil nuri... .....	28
Merr të çlodhur nëpër valle .....	32

### MOTIVE NGA JETA E RE

Qyteti i minatorëve të Memaliajt .....	34
Zemër e rinuar .....	36

Nénat .....	38
Mbrëmje prilli .....	40
Vëllai po ma vonon nënën .....	42
Lukovë .....	43
Në qytetin tim .....	45

### MOTIVE NGA LUFTA NACIONALÇLIRIMTARE

Net gjëmimesh .....	46
Mali u pa në pasqyrë .....	47
Malet krah' i kemi... .....	49
Balada e mullixhiut .....	51
Kur bie për atdheun .....	53

### KJO DASHURIA JOTE

1. Kur vije ti... .....	54
2. Kjo dashuria jote .....	55
3. Deti i fjalëve dhe prushi i punës .....	56
4. Ai do më vijë... .....	58
5. Kthjelltësi .....	59

Ora .....	60
Nëna ime me shtatë nure .....	61
Njeriu i vockël .....	63
Bilbili dhe palloi .....	64
Zëri që gjëmon .....	66
Kur i zë besë pabesisë .....	68
Në veten tënde .....	70
Biri i maleve .....	71
Malli i Selam Musa Salarisë .....	75